

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Pasuria e brendshme¹ / *el-Ghinaa* / الْغِنَى

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَى"

"Dhe Ai të gjeti të varfër e të pasuroi²." (ed-Duhaa, 8)

Pasuria e brendshme (*ghinaa*) ka të bëjë me pronësi³ të plotë. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është pasuria e zemrës, gjë që ka të bëjë me:

- Rehatinë e shpëtimit nga (mbështetja në) shkaqet.⁴
- Paqësimin me caktimet.⁵

¹ Kuptimi i drejtpërdrejtë i *ghinaa* është pasuri/bollëk. Kjo për ndjekësin e shtegut të pastrimit shpirtëror nënkupton lirim nga dëshirat/nevojat e kësaj bote.

² Kjo i referohet edhe pasurisë materiale, edhe asaj shpirtërore. Pejgamberi ﷺ jetoi një jetë të përmbajtur, por që i lirë nga nevojat për ndokënd tjetër veç Zotit të tij. Ai e luste Allahu duke thënë: "Ma heq barrën e borxhit dhe na jep që të mos mbesim të varfër." (Muslim)

³ Pronësia e krijesave është e përkohshme dhe e varur. Në të vërtetë, askush s'është i vetëmjaftueshëm, përveç Allahut. Pasuria jonë e brendshme (*ghinaa*) realizohet nëpërmjet Tij. Pasuria që i atribuohet ndjekësit të shtegut të pastrimit shpirtëror këtu është pasuria nëpërmjet Allahut. Ai - i lartësuar qoftë! - tha: "O njerëz, ju jeni ata që keni nevojë për Allahun, kurse Allahu është i vetëmjaftueshëm, lavdiplotë." (Faatir, 15)

⁴ Në përputhje me proceset natyrore të caktuara nga Allahu (*nawaamiis*), personi duhet të angazhohet në shkaqe, por mbështetja e tij duhet të jetë krejtësisht në Shkaktarin.

⁵ Urdhrat dhe ndalimet duhet të pranohen më gjithë zemër. Caktimi universal po ashtu duhet të pranohet me durim dhe falënderim. Gjërave të padëshirueshme duhet

- Heqjen dorë nga antagonizmi (kundërshtimi i papajtueshëm).⁶

Niveli i dytë është pasuria e nefsit⁷ (unit), gjë që ka të bëjë me:

- Ndjekjen e vazhdueshme (nga nefsi) të qëllimit përfundimtar (Allahut).
- Rehatinë e shpëtimit (të nefsit) nga të urryerat.⁸
- Heqjen dorë (të nefsit) nga të mbajturit me të madh (mburrja).

Niveli i tretë është të mjaftuarit me të Vërtetin⁹, gjë që zërthehet më tej në tri nivele të tjera:

- Mbajtja parasyshe e kujtimit që Ai ta bën ty.
- Të parët e paraekzistencës së Tij.
- Suksesi (yt) madhor i gjetjes së Atij.¹⁰

t'u rezistosh derisa të ndodhin; pasi të ndodhin, duhet t'i pranosh me durim dhe të punosh me kujdes që ndikimet (pasojat) të zvogëlohen.

⁶ Ai që ka s'ka nevojë për krijesat, nuk do të jetë antagonist, për shkak të lakmisë ose konkurrencës së tepërt. Megjithatë, ai do të kundërshtojë dhe do të rezistojë për kauzën e mirë të drejtësisë hyjnore.

⁷ Kurse veprat e zemrës janë më të mëdha (më të rëndësishme), Ibn el-Kajjim shpjegon në *el-Medaarixh* se el-Harawi përmendi nefsin në këtë nivel, për shkak se nefsi është rebeli më i madh nga të gjithë të nënshtruarit e zemrës dhe rruga për ngritjen në nivelin e tretë trasohet vetëm pasi ai të zbutet tërësisht.

⁸ Ambiciet e ulëta.

⁹ Allahu thotë: "A nuk i mjafton Allahu robit të Tij?" (ez-Zumer, 36)

¹⁰ Të parët e Atij me "sytë e zemrës" në këtë botë dhe me sytë e kokës në botën tjetër.